

20251923938

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR TË DREJTAT E BARTËSVE TË “PËRKUJTIMORES
PARTIZANE 1941”, TË PERSONAVE TË DEKORUAR ME MEDALJE HERO
I POPULLIT DHE TË LUFTËTARËVE TË LUFTËS
NACIONALÇLIRIMTARE DHE REVOLUCIONARE
SPANJOLLE NGA VITI 1936 DERI MË 1939**

Neni 1

Në Ligjin për të Drejtat e Bartësve të “Përkujtimores Partizane 1941”, të Personave të Dekoruar me Medalje Hero i Popullit dhe të Luftëtarëve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe Revolucionare Spanjolle nga viti 1936 deri më 1939 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 75/1993), në nenin 3 fjalët “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 2

Në nenin 4, paragrafi 4, fjalët “Ministri i Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët “Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve”.

Në paragrafin 6 fjalët “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Neni 3

Në nenin 6, paragrafi 1, fjalët “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve”.

Në paragrafet 3 dhe 4, fjalët “Ministri i Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët “Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe i të Rinjve”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.